

**VENDIM I ASAMBLESË SË PËRGJITHËSHME TË ORTAKËVE  
(ORTAKUT TË VETËM)**

**"CNA Media"sh.p.k**

është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar shqiptare, themeluar në datë. 08/08/2017, regjistruar në mënyrë të rregullt në Qendrën Kombëtare të Biznesit ("QKB"), me Numer Unik Identifikimi të Subjektit NUIS L72011012I, ("Shoqëria").

**Vendi i Mbledhjes:** Mbledhja është bërë në selinë e shoqërisë CNA Media sh.p.k me adrese Rruga Selita e Vjetër, përballë derës së Kopshtit Botanik, Zona Kadastrale 8270, Tiranë.

**Data e Mbledhjes:** 19.05.2022

**Nr i vendimit** 1

**Prezent në mbledhje është Ortaku i Vetëm i shoqërisë z.Elvi Fundo.**

Asambleja është thirrur rregullisht dhe është e aftë të marrë vendime të vlefshme lidhur me rendin e ditës si më poshtë vijon:

**Rendi i Dites**

1. Fillimi i procedurave për zmadhimin e kapitalit të Shoqërisë me anë të heqjes dore nga financimet e ortakut të Vetëm në shkëmbim të rritjes së vlerës së kapitalit. Vlera totale e financimeve që do të hiqet dorë është 3,940,000 lekë
2. Miratimin e Audituesit Ligjor për të përgatitur raportin për rritjen e kapitalit;
3. Te ndryshme

**DUKE QËNË SE :**

"CNA Media" sh.p.k është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar shqiptare, themeluar në datë. 08/08/2017, regjistruar në mënyrë të rregullt në Qendrën Kombëtare të Biznesit ("QKB"), me Numer Unik Identifikimi të Subjektit NUIS L72011012I, ("Shoqëria")

Shoqëria me aktivitetin e saj ka investuar dhe po investon për zgjerimin e kapaciteteve dhe zgjerimin e aktivitetit. Gjatë viteve ortakut i vetëm i shoqërisë z.Elvi Fundo ka financuar shoqërinë duke mostërhequr dividendet por edhe nëpërmjet derdhjes së likujditeteve.

Para fillimit të rritjes së kapitalit shoqëria ka një kapital të regjistruar në QKB prej 100,000 leke i ndarë në 1 kuotë. Ortaku i Vetëm i shoqërisë ka vendosur të heq dorë nga kërkesa e detyrimit që shoqëria "CNA Media" i ka deri në datë 18 Maj 2022 në shumën 3,940,000 leke dhe me këtë vlerë të zmadhoj kapitalin e shoqërisë.

Te gjitha kërkesat për mbajtjen e një mbledhje të rregullt janë përmbushur në përputhje me Statutin e Shoqërisë dhe Ligjin Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare.

PER SA ME SIPER, Ortaku i Vetëm i shoqërisë "CNA Media" sh.p.k

**VENDOSI :**

1. Te miratoje fillimin e procedurës për zmadhimin e kapitalit të shoqërisë me anë të heqjes dore nga financimet e orkut të Vetëm në vlerë totale 3.940.000 ( Tremiljon e nentëqinda e dyzetë mijë ) lekë.
2. Te miratoje emerimin në cilësinë e Audituesit Ligjor për hartimin e raportit përkatës për rritjen e kapitalit si me sipër shoqërine I.L.D.-99 Audit sh.p.k shoqëri e audituese me partnerë angazhimi nga z. Luan Kamberi, lindur më 23.02.1965, në Tepelene, Shqipëri, banues në Rr. "Komuna e Parisit", Tiranë, Shqipëri, mbajtes i licenses Nr. 40, datë 10.02.2000.
3. Te ngarkojë Administratorin e shoqërisë znj. Etleva Skonja të bëjë depozitimin e të gjithë akteve të zmadhimit të kapitalit pranë Qendres Kombëtare të regjistrimit Tiranë.

Asnjë vendim tjetër nuk u morr në këtë mbledhje të Përgjithëshme të Asamblesë së Ortakëve të Shoqërisë.

Ortaku i Vetëm i shoqërisë "CNA Media" sh.p.k

Elvi FUNDO



**« CNA Media » SH.P.K**

**RAPORTI I DHËNIES SË SIGURISË  
I AUDITUESIT LIGJOR**

**Mbi verifikimin e llogarisë së detyrimit dhe derdhjeve të Ortakut të Vetëm,  
Për qëllim të zmadhimit të kapitalit themeltar të shoqërisë  
sipas vendimit të Asamblesë së Ortakëve (Ortakut të Vetëm) nr.1 datë 19/05/2022**

## **RAPORT I DHËNIES SË SIGURISË I AUDITUESIT LIGJOR**

**Drejtuar: ORTAKUT TË VETËM TË SHOQËRISË**  
**“ CNA Media ” sh.p.k**

### **Qëllimi i Angazhimit:**

Asambleja e ortakëve (Ortaku i Vetëm) i shoqërisë me vendimin nr.1 datë 19 Maj 2022, na ka angazhuar si auditues ligjor për të verifikuar dhe për të dhënë siguri të arsyeshme në lidhje me detyrimin e shoqërisë për ortakun e Vetëm sipas gjëndjes së llogarisë në Pasqyrat Finaciare të shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2021 dhe derdhjeve të tjera deri në 18 Maj 2022, për qëllim zmadhimin e kapitalit të shoqërisë “ CNA Media ” sh.p.k

### **Kriteret**

Për të përmbushur këtë angazhimin ne jemi bazuar në:

- Kapitalin e regjistruar të shoqërisë “CNA Media ” sh.p.k dhe strukturën e kuotave në përputhje me të dhënat e shoqërisë sipas “Ekstraktit të regjistrimit tregtar për të dhënat e subjektit të Qendrës Kombëtare të Biznesit dt 16 Maj 2022.
- Vendimin e Asamblese së ortakëve nr.1 datë 19 Maj 2021 (bashkëngjitur këtij Raporti)
- Dokumentacionin që vërteton derdhjet e ortakëve deri në 31.12.2021.
- Pasqyrat Finaciare të shoqërisë për priudhen deri në 31.12.2021.
- Dy transfertat e kryera nga Ortaku i Vetëm në Credis Bank datë 14.04.2022 dhe datë 17.05.2022
- Standardet Kombëtare të Kontabilitetit. Ligjin Nr.25 date 10.05.2018 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Finaciare”,
- Ligjin Nr.9901 date 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, Pasqyrat Finaciare të shoqërisë të audituara të datës 31.12.2019 .

### **Përgjegjësia e Drejtimit**

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të të gjitha pasqyrave për qëllim të zmadhimit të kapitalit (në vijim pasqyrat finaciare), përgatitjen e akteve juridike dhe të zbatimit të procedurave ligjore e statutore të nevojshme për zmadhimin e kapitalit në përputhje me kriteret e sipërpërmendura.

Kjo përgjegjësi përfshin: përcaktimin, ushtrimin dhe mbajtjen e kontrollit të brendshëm të përshtatshëm për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të pasqyrave finaciare të cilat nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë si rezultat i mashtrimeve apo gabimeve; zgjedhjen dhe zbatimin e parimeve të duhura kontabël; dhe kryerjen e çmuarjeve kontabël të arsyeshme për rrethanat finaciare.

Drejtimi është përgjegjës për respektimin e të drejtave të ortakut të Vetëm dhe kryerjen e llogaritjes së drejtë të kuotës dhe vlerës së sajë, në momentin e zmadhimit të kapitalit dhe për respektimin e modaliteteve ligjore dhe statutore për thirrjen e asamblesë me rend dite zmadhimin e kapitalit themeltar.



## Përgjegjësia jonë

Përgjegjësia jonë është që, bazuar në procedurat e kryera, të shprehim një opinion mbi llogarinë e Ortakut dhe derdhjet e kryera dhe nëse këto derdhje janë të pasqyruara saktë në kontabilitet dhe nëse shuma e përcaktuar për rritjen e kapitalit është e saktë dhe përputhet me kontabilitetin. Ne e kryem auditimin në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Angazhimeve të Dhënies së Sigurisë (SNAS 3000) "Angazhime të dhënies së Sigurisë që ndryshojnë nga Auditimet apo rishikimet e Informacioneve Financiare Historike" dhe standardet e tjera që lidhen me çështjen në fjalë. Këto standarde kërkojnë që ne të planifikojmë dhe të kryejmë procedurat e nevojshme për të dhënë një nivel sigurie të arsyeshëm që informacionet e përgatitura nga drejtimi i shoqërisë janë të vërteta dhe të sinqerta në të gjitha aspektet materiale dhe në aspektin e tyre matematikor, financimet e kryera nga ortaku i vetëm të mund të përdoren për qëllim të zmadhimit të kapitalit themeltar të shoqërisë.

### Procedurat e kryera nga ana jonë për këtë angazhim përfshijnë:

Bazuar në dokumentacionin që na është vënë në dispozicion nga Drejtimi i shoqërisë "CNA Media " sh.p.k procedurat e kryera nga ana jonë përfshijnë:

1. Verifikimin e llogarise "Detyrime ndaj Ortakut të Vetëm" të pasqyruara në llogarinë Detyrime afatgjata dhe përputhshmërinë e tyre me ato të paraqitura në Pasqyrat Financiare të vitit ushtrimor të mbyllur më 31 Dhjetor 2021.
2. Verifikimin e kontributeve të derdhura nga ortaku i vetem i shoqërisë nga 1 Janari 2022 deri më 18/05/2022.
3. Përputhshmërinë e detyrimeve ndaj Ortakut dhe derdhjeve deri ne 18 Maj 2022 me vleren 3,940,000 leke që do të përdoren për rritjen e kapitalit të shoqërisë.

### Konkluzioni:

1. Bazuar në procedurat e kryera, shuma e kapitaleve të veta sipas Pasqyrave Financiare të mbyllura më 31.12.2021 janë si më poshtë:

	<u>31.12.2021</u>
Kapitali i nënshkruar	100,000
Fitime/Humbje te mbartura	(619,966)
Rezultati i vitit ushtrimor	(270,540)
<b>Shuma e Kapitaleve të veta</b>	<u><b>(790,506)</b></u>

Këto shuma rakordojnë me llogaritë përkatëse dhe dokumentacionin mbështetës që ne verifikuam. Pasqyra e kapitaleve të veta si më sipër, jep një pasqyrim të sinqertë dhe të vërtetë të gjendjeve të Kapitaleve të Veta për ushtrimin e mbyllur më 31 Dhjetor 2021.



Shuma e llogarisë "Tituj të huamarrjes afatgjatë" , që janë pasqyruar në Pasqyrat Financiare të shoqërisë që do të përdoren për të realizuar shtesën e kapitalit të shoqërisë paraqitet sipas tabelës në vijim:

	<u>31.12.2021</u>
Detyrime Afatëgjata	
Tituj të huamarjes afatëgjat	<u>3,103,142</u>
<b>Kjo shumë përbëhet</b>	
Divident i pa tërhequr nga Ortaku i vetëm	<u>1,584,484</u>
Derdhje në vite nga Ortaku i Vetëm	<u>1,518,658</u>
<b>Shuma që mund të kalojë për zmadhimin e kapitalit</b>	<u><b>3,103,142</b></u>

Shuma e detyrimeve ndaj Ortakut, prej 3,103,142 lekë e përcaktuar në vendimin nr.1 datë 19/05/2022 për rritjen e kapitalit themeltar është në përputhje derdhjet e ortakut si edhe me dividendin e pa tërhequr; kjo shumë mund të përdoret lirisht për zmadhimin e kapitalit të shoqërisë.

2. Shuma e financimeve të ortakut të vetëm të shoqërisë z.Elvi Fundo të bera gjatë vitit 2022 që do të përdoret për të realizuar shtesën e kapitalit të shoqërisë është sipas tabelës në vijim:

Emri i bankës	Data	Vlera në Euro	Vlera ne lekë
Credins bank	14.04.2002	4,000	484,160
Credins bank	17.05.2022	3,000	361,560
Shuma për zmadhimin e kapitalit		<u>7,000</u>	<u>845,720</u>

Shumat e derdhjeve, janë në përputhje me dokumentat kontabel që vërtetojnë derdhjen e këtyre shumave.

Këto shuma me vendim të asamblesë së ortakeve të shoqërisë, mund të përdoren për zmadhimin e kapitalit të shoqërisë.

Në total shumat që mund të përdoren për rritjen e kapitalit nga detyrimi për Ortakun dhe financimet është 3,948,862 lekë.

3. Llogaria e detyrimeve për Ortakun e vetëm të shoqërisë z.Elvi Fundo dhe derdhjeve të bëra gjatë vitit 2022 që do të përdoren për rritjen e kapitalit dhe Vlerës së kuotes, pasqyron me vërtetësi shumat e kontributeve të ortakut të shoqërisë dhe përputhet me vlerat e derdhjeve si më sipër. Këto pasqyra paraqesin me korrektesi nga ana matematikore shumat e që do të përdoren për rritjen e Kapitalit të shoqërisë mbas miratimit të rritjes së kapitalit nga Ortaku i Vetëm i shoqërisë "CNA Media " sh.p.k Mbasi miratimit të rritjes së kapitalit nga Ortaku i Vetëm,kapitali shoqërisë "CNA Media " sh.p.k bëhet si më poshtë:



- Kapitali themeltar i shoqërisë " CNA Media" sh.p.k ishte 100,000 lekë, rritet edhe me 3,940,000 lekë dhe bëhet 4,040,000 lekë.
- Vlera e kuotës mbas rritjes se kapitalit nga 100,000 leke do të bëhet 4,040,000 lekë;
- Zotrues i kapitalit të shoqërise është Ortaku i Vetëm i saj z.Elvi Fundo.

Me respekt

Luan Kamberi  
Auditues Ligjor



Tirane më 23 Maj 2022

**VENDIM I ASAMBLESË SË PËRGJITHËSHME TË ORTAKËVE  
(ORTAKUT TË VETËM)**

**"CNA Media"sh.p.k**

është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar shqiptare, themeluar në datë. 08/08/2017, regjistruar në mënyrë të rregullt në Qendrën Kombëtare të Biznesit ("QKB"), me Numer Unik Identifikimi të Subjektit NUIS L72011012I, ("Shoqëria").

**Vendi i Mbledhjes:** Mbledhja është bërë në selinë e shoqërisë CNA Media sh.p.k me adrese Rruga Selita e Vjetër, përballë derës së Kopshtit Botanik, Zona Kadastrale 8270, Tiranë.

**Data e Mbledhjes:** 24.05.2022

**Nr i vendimit** 2

**Prezent në mbledhje është Ortaku i Veteëm i shoqërisë z.Elvi Fundo.**

Asambleja është thirrur rregullisht dhe është e aftë të marrë vendime të vlefshme lidhur me rendin e ditës si më poshtë vijon:

**Rendi i Dites**

1. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të Audituesit Ligjor për zmadhimin e kapitalit të Shoqërisë nga kontributi i ortakut të Vetem me anë të heqjes dore nga financimet në shoqëri në shumën 3,940,000 leke
2. Shqyrtimi dhe miratimi i rritjes së kapitalit të shoqërisë;
3. Te tjera.

Pas diskutimit të çështjeve duke qenë se të gjitha kërkesat për mbajtjen e një mbledhje të rregullt janë përmbushur në përputhje me Statutin e Shoqërisë dhe Ligjin Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare Ortaku i Vetëm shoqërisë "CNA Media" sh.p.k :

**VENDOSI**

1. **Te miratojë Raportin e Audituesit Ligjor I.L.D-99 Audit sh.p.k për zmadhimin e kapitalit të Shoqërisë "CNA Media" sh.p.k në shumën 3,940,000 (Tremiljon e neteqinde e dyzete mijë ) leke, nga kontributi i Ortakut nepermjet heqjes dore nga kthimi i financimeve.**  
**- Pra kapitali i nenshkruar i shoqërisë nga 100,000 leke rritet dhe me 3,940,000 leke dhe bëhet 4,040,000 leke.**



- Numri i kuotave mbas rritjes se kapitalit si me siper mbetet 1 kuote dhe vlera e re e kuotes mbas zmadhimit te kapitalit do te jete 4,040,000 leke.

2. Te miratojne rritjen e kapitalit themeltar si me poshte:

- Kapitali themeltar i shoqerise nga 100,000 leke (njqinde mije ) rritet edhe me 3,940,000 leke (tremiljon e neteqinde e dyzete mije) leke dhe behet 4,040,000 leke (Katermiljon e dyzete mije ) leke.
- Kapitali eshte i ndare ne 1 pjese me nje vlere nominale prej 4,040,000 Leke (Katermiljon e dyzete mije ) leke .

3. Te ngarkoje Administratorin e shoqerise znj.Etleva Skonja te bej depozitimn e te gjitha akteve te zmadhimit te kapitalit prane Qendres Kombetare te rregjistrimit Tirane.

Asnje vendim tjetër nuk u morr ne kete Mbledhje te Pergjitheshme te Asamblese se Ortakeve te Shoqerise.

Për sa u diskutua në mbledhje u mbajt ky proces verbal, i cili nënshkruhet nga Ortaku i Vetem pasi ai u lexua me zë të lartë.

Ortaku i Vetëm i shoqerisë "CNA Media" sh.p.k

Elyza VUNDI

